



Tiranë më, 09.04.2026

FTESË PËR OFERTË

ME OBJEKT: RIPARIM DHE MIRËMBAJTJE TË AUTOMJETEVE TË SHOQATËS SOS FSHATRAT E FËMIJËVË SHQIPËRI

Shoqata SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri është një organizatë sociale, jo-politike dhe jo fetare, që ofron kujdes afatgjatë me bazë familjare për fëmijët, të cilët kanë humbur kujdesin prindëror, apo që për arsye të ndryshme nuk mund të jetojnë në familjet e tyre biologjike.

SOS Fshatrat e Fëmijëve mbështet gjithashtu fëmijët, të rinjtë dhe familjet në nevojë përmes projekteve, që synojnë zhvillimin e kapaciteteve të këtyre familjeve.

SOS Fshatrat e Fëmijëve është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare, SOS Kinderdorf International, krijuar nga Herman Gmeiner në vitin 1949. Ajo është prezente në 136 vende në botë në shërbim të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve.

Misioni ynë: Ne krijojmë familje për fëmijët në nevojë, ne i ndihmojmë ata që të ndërtojnë të ardhmen e tyre dhe marrim pjesë në zhvillimin e komuniteteve të tyre.

Qëllimi i kësaj kërkesë për ofertë është për të krijuar një kontratë me një kompani të licencuar për riparimin e automjeteve të Shoqatës SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri.

Për ofrimin e këtij shërbimi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri fton të gjitha kompanitë që kanë licensë për ushtrimin e kësaj veprimtarie, që të paraqesin interesin e tyre brenda datës 22/04/2026, duke paraqitur ofertat financiare dhe dokumentat plotësuese nëpërmjet postës elektronike në adresën info@soskd.org.al

MËNYRA E PJESËMARRJES NË TENDER

Jeni të ftuar të dorëzoni ofertën tuaj me e-mail me subjekt “Ofertë për Riparim te automjeteve të Shoqatës SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri” dhe emrin e kompanisë që e dorëzon, deri më datë **22.04.2026**, me adresë: info@soskd.org.al

Oferta duhet të jetë e vlefshme për minimumi 30 ditë.

Dokumentat që duhet të përmbajnë:

1. Të gjitha dokumentat e kerkuara ne dokumentin e specifikimeve teknike të shprehura në shtojcën nr. 1 (specifikimet teknike për tenderin e riparimit të automjeteve të SOSFF)
2. Oferten financiare sipas zërave te punimeve të kerkuara përkatësisht sipas shtojcës nr. 2.

Për çdo pyetje ose sqarim mund të na shkruani në e-mail: info@soskd.org.al

Përgjigjet e pyetjeve do të ndahen me të gjitha kompanitë që marrin pjesë në tender në version elektronik.



Vlerësimi i ofertave:

Të gjithë ofertuesit do të vlerësohen për plotësimin e dokumentacionit, specifikimeve teknike si dhe cmimeve të ofruara për zërat përkatës.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri nuk është përgjegjës për ndonjë kosto që lidhet me përgatitjen e dokumentave të tenderimit nga ofertuesit.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri inkurajon çdo ofertues të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.

Çdo ofertë e marrë pas datës së mbylljes së tenderit nuk do të pranohet.

Bashkëngjitur njoftimit do të gjeni:

1. Shtojca nr. 1 - Specifikimet teknike për tenderin e riparimit të automjeteve të SOSFF;
2. Shtojca nr. 2 - Oferta financiare me zërat përkatës të punimeve/shërbimeve, e cilat duhet plotësuar për secilin prej automjeteve;
3. Shtojca nr. 3 - Lista e automjeteve në pronësi të Shoqatës SOSFF me të dhënat teknike të nevojshme.